



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

INFORMATË PËR VIZITËN NË SEKSIONIN POLICOR –HARAÇINË

Më datën 10.07.2014 Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Seksionin policor-Haraçinë. MPN realizoi vizitë të paparalajmëruar në seksionin policor me qëllim të përcaktimit të gjendjeve dhe kushteve në vet seksionin.

Konform nenit 49 paragrafit 1 të Ligjit për punë të brendshme në Ministrinë për Punë të Brendshme në organet të cilat janë në përbërje të Ministrisë, formohen njësitë organizative në vijim:

- Shërbime qendrore policore, të formuara konform Ligjit për policinë;
- Seksioni,
- sektori, përkatësisht njësia,
- seksioni, përkatësisht çeta,
- dega, përkatësisht stacioni policor, përkatësisht zyrë e jashtme dhe
- seksioni policor.

Inspektim në Seksionin policor-Haraçinë

Vizita në seksionin policor u realizua në kuadër të mandatit të cilin e ka Mekanizmi Parandalues Nacional. Mandati dhe kompetencat burojnë nga Protokollin Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligjit për Avokatin e Popullit.

Konform Protokollit Fakultativ MPN realizon vizita në vende ku personat janë ose mund të jenë të privuar nga liria me qëllim të mbrojtjes nga tortura ose llojit tjetër të trajtimit brutal, johuman, nënçmues ose ndëshkues. Privimi nga liria don të thotë çdo formë e paraburgimit ose burgimit, ose ndalimit të personave në entet e mbyllura publike ose private, në të cilët personit nuk i lejohet që vullnetarisht të largohet, ndërkaq me urdhër të gjykatës ose organit tjetër administrativ.

Fillimisht MPN realizoi bisedë me zyrtarin kompetent policor të seksionit policor, ndërsa mëtej MPN realizoi inspektim në vendet të cilat kanë qenë të dedikuara për ndalim të personave të privuar nga liria, sallën për mbledhje, tualetët etj. Nga vizita në seksionin policor MPN konstatoi se bëhet fjalë për objekt të ri të ndërtimit të fortë, në të cilin gjenden edhe dy ambiente për ndalim dhe tualetë të veçantë. Pranë harjes së seksionit është vendosur barrierë për persona me aftësi të kufizuara. Konform informatave të pranuar nga zyrtari policor, ky seksion nuk është në funksion, përkatësisht nuk shfrytëzohet prej momentit kur janë emëruar stacionet mobile policore.